



**Kom.Dh.Shk.II.nr.46/2022**

**GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë**, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Ujësjetllësi Rajonal “Prishtina” sh.a, me seli në Prishtinë rr. “Tahir Zajmi” p.n, ndaj debitorit KEDS-Distribucioni Ferizaj-Shtime, rr. “Tirana”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore për pagimin e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit dhe debitorit, të ushtruar kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PP.nr.793/2015, të datës 29.09.2017, me datë **24.08.2022**, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**Aprovohen** si te themelta ankesa e kreditorit Kompania Ujësjetllësi Rajonal “Prishtina” sh.a, me seli në Prishtinë rr. “Tahir Zajmi” p.n, dhe ankesa e debitorit KEDS-Distribucioni Ferizaj-Shtime, rr. “Tirana”, me seli në Prishtinë, ndërsa **anulohet** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PP.nr.793/2015, të datës 29.09.2017, çështja i kthehet gjykatës në procedim të serishëm, Gjykatës Komerciale, Dhomës se Shkallës se Parë .

### **A r s y e t i m**

Gjykata shkallës e së parë, me aktvendimin e atakuar, PP.nr.793/2015, të datës 29.09.2017, ka vendosur: “I. Aprovohet pjesërisht si i bazuar, prapësimi i debitorit të përmbartimit: "KEDS-Distribucioni Ferizaj-Shtime", rr."Tirana".III-000, me seli në Prishtinë, për pjesën e borgjit në shumën prej 8,769.25€ i krijuar dhe arritur për pagesë deri më dt:31.12.2012, ndërsa Urdhri i Përmbartueses Private Emine Sherifi-Lubeniqi P.nr.93/2014 të dt:04.09.2014, për këtë pjesë shfuqizohet. II. Refuzohet si i pabazuar, prapësimi i debitorit të përmbartimit: "KEDS Distribucioni Ferizaj-Shtime", rr."Tirana"III-000, me seli në Prishtinë, për pjesën e borgjit në shumën prej 1,407.55€ i krijuar dhe arritur për pagesë nga dt:01.01.2013 deri më dt:31.07.2014, dhe Urdhri i Përmbartueses Private Emine Sherifi-Lubeniqi P.nr.93/2014 të dt:04.09.2014, për këtë pjesë mbetet në fuqi. III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të

paguaj garancinë në gjykatë në shumë prej 1,407.55 euro. IV. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.”

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes esenciale së dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, të aprovojë në tërësi si të bazuar ankesën e kreditorit ndërsa aktvendimin e ankimuar ta anuloi për pikën I dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose ta ndryshoj aktvendimin e atakuar dhe ta refuzoi prapësimin e debitorit, me arsyetim se borxhi është parashkruar.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale së dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, të aprovojë si të bazuar ankesën e debitorit, të prish aktvendimin e atakuar në pjesën refuzuese të saj ashtu që propozimi për përmbarimi i kreditorit të refuzohet në tërësi si i pa bazuar. Si dhe ka kërkuar që të obligohet kreditori t’i bart shpenzimet për kundërshtim në lartësi prej 21.00€ si dhe shpenzimet e ankesës sipas UA 2008/2 për taksat gjyqësore, si dhe t’i kthehet debitorit shuma prej 1,407.55€ në emër të garancisë në gjykatë.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktvendimit të ankimuar dhe pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

**-Ankesat e kreditorit dhe debitorit janë të themelta.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Ujesjellesi Rajonal “Prishtina” sh.a. me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit KEDS-Distribucioni Ferizaj-Shtime, rr. “Tirana”, në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit me numër 2803, në vlerë prej 10,176.80 Euro, për kryerjen e shërbimeve publike – furnizimin me ujë të pijshëm. Përmbaruesi Privat Emine Sherifi-

Lubeniqi, ka lejuar përmbarrimin me urdhrin P.nr.93/2014, të datës 04.09.2014, ndaj të cilit urdhër debitori ka ushtruar prapësim duke theksuar se kompania KEDS është privatizuar dhe nuk është trashëgimtar juridik i KEK sh.a dhe nuk është përgjegjës për detyrimet e krijuara nga KEK sh.a para datës 08.05.2013, andaj i propozon gjykatës së shkallës së parë të aprovoi prapësimin e debitorit dhe të anuloi urdhrin përmbarrimor, si dhe kreditori t'i bart shpenzimet procedurale.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se kreditori rregullisht ka pranuar faturat nga kreditori dhe nuk ka pasur asnjë kontestim për atë prej datës 01.03.2005 deri me datën 08.08.2014, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.793/15, të datës 29.09.2017, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se pretendimet e debitorit për parashkrimin e borxhit janë të bazuara, për faktin se në nenin 378 par.1 të LMD-së thuhet se kërkesat për kompensimin e ujit parashkruhet për një vjet. Duke marr para sysh se kreditori propozimin për përmbarrim e ka parashtruar me datë 01.09.2014, me të cilin ka kërkuar borxhin për periudhën 2001 deri me datën 30.06.2014, gjykata pas vlerësimit të afateve të parashkrimit lidhur me ekstraktin e verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me ID nr.679 ka gjetur se për pagesat e të njëjtës për periudhën lartpërmendur, ka arritur parashkrimin i kërkesave për arsye se borxhi është nga viti 2001 deri datën 01.09.2013, ndërsa propozimi për përmbarrim të Përmbarruesi Privat është parashtruar me datë 01.09.2014, respektivisht pasi ka kaluar afati i parashkrimit më shumë se 1 (një) vit.

Gjykata Komerciale, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore në kuptim të nenit 182 pika (n) duke qenë se aktvendimi i atakuar ka të meta të tilla të cilat nuk mund të ekzaminohen, ku dispozitivi i aktvendimeve është i pakuptueshëm, ku arsyet janë të paqarta dhe kontradiktore, e po ashtu aktvendimet e atakuar janë marr me

vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë konstaton se në aktvendimin e atakuar pjesa hyrëse dhe diapozitivi janë në kundërshtim me arsyetimin, ku në pjesën hyrëse dhe në dispozitiv gjykatat e shkallës së parë kreditorit i referohet KRU Prishtina sh.a derisa në arsyetim në cilësinë e kreditorit është përmendur KPM Pastrimi, mirëpo nga shkresat e lëndës rezultojnë se kreditor në këtë çështje është KRM Pastrimi.

Gjykata e shkallës së dytë po ashtu konstaton, se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale në kuptim të nenit 184 të LPK-së, kur ka zbatuar nenin 378 par.1.1 të LMD-së, mbi gjendjen e vërtetuar faktike në mënyrë të gabuar kur ka vërtetuar se kemi parashkrim të kërkesës me kalimin e afatit një vjeçar nga dita e lëshimit të faturës. Gjykata në rastin konkret gabimisht ka aplikuar këtë dispozitë materiale, pasi që nenin 378 shprehimisht ka përcaktuar se kjo dispozitë rregullon situatat në rastet kur kemi raport kontraktual të detyrimit në mes të ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime të komunalive dhe amvisërive, derisa në rastin konkret raporti kontraktual rezultojnë të jetë në mes të dy personave juridik, që për nga forma e organizimit janë shoqëri aksionare.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, si dhe të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm-ekstraktin nga librat afarist e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Kompetenca e Gjykatës së Komerciale, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së (i cili është në fuqi aktualisht, me numër 04 L-139), me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE - Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.46/2022, me datë 24.08.2022**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**

*d.v.*